

SINODI I IPESHKVIJVE 2021-2023

UDHËZIMET E PUNËS



Për një Kishë sinodale
bashkim | pjesëmarrje | mision



Konferenca
Ipeshkvnore e Shqipërisë

Për një Kishë sinodale: bashkim, pjesëmarrje dhe mision

Dokument përgatitës

Siglat

- CTI Komisioni Teologjik Ndërkombëtar
- DV Koncili II-të i Vatikanit, Kushtetuta dogmatike “*Dei Verbum*” (18 nëntor 1965)
- EC Françesku, Kushtetuta Apostolike “*Episcopalis communio*” (15 shtator 2018)
- EG Françesku, Nxitja Apostolike “*Evangelium Gaudium*” (24 nëntor 2013)
- FT Françesku, Letra Enciklike “*Fratelli Tutti*” (3 tetor 2020)
- GS Koncili II-të i Vatikanit, Kush. Past. “*Gaudium et spes*” (7 dhjetor 1965)
- LG Koncili II-të i Vatikanit, Kush. Dog. “*Lumen Gentium*” (21 nëntor 1964)
- LS Françesku, Letra Enciklike “*Laudato si*” (24 maj 2015)
- UR Koncili II-të i Vatikanit, Dekreti “*Unitatis redintegratio*” (21 nëntor 1964)

1. Kisha e Hyjit është e thirrur në Sinod. Ecja me titull “Për një Kishë sinodale: bashkim, pjesëmarrje dhe mision”, do të hapet solemnisht me 9-10 tetor 2021 në Romë dhe në 17 tetorin e ardhshëm në çdo Kishë të veçantë. Një etapë themelore do të jetë kremtimi i XVI i Asamblesë së Përgjithshme të Rregullt të Sinodit të Ipeshkvijve në tetorin e vitit 2023¹, ku më pas do të vijë faza zbatuese, që do të përfshijë sërish Kishat e veçanta (krah EC, artikulli 19-21). Me këtë thirrje, Papa Françesku e fton mbarë Kishën që të pyetet mbi një temë vendimtare për jetën dhe misionin e saj:

“Pikërisht ecja e sinodalitetit është rrugëtimi që Zoti pret nga Kisha e mijëvjeçarit të tretë”². Ky itinerar, i cili është pjesë e “përditësimit” të Kishës së propozuar nga Koncili i II-të i Vatikanit, është një dhuratë dhe një detyrë: duke ecur (rrugëtuar) së bashku dhe së bashku duke reflektuar rreth rrugëtimit të kryer, Kisha do të mund të mësojë nga ajo që do të përjetojë, se cilat procese mund ta ndihmojnë ta jetojë bashkimin, të realizojë pjesëmarrjen, t’i hapet misionit. Të “ecurit (rrugëtuarit) së bashku”, në fakt, është ajo që më së shumti zbaton dhe dëfton (shfaq) natyrën e Kishës si Popull i Hyjit, shtegtar dhe misionar.

2. Një pyetje e thellë na shtyn dhe na prin: si ta realizojmë sot, në nivele të ndryshme (nga ato lokale (*vendore*) tek ato universale) atë “ecje (rrugëtim) së bashku”, e cila i mundëson Kishës të shpallë Ungjillin në përputhje me misionin që i

1 Poshtë, në formë skematike, sjellim etapën e ecjes sinodale.

2 FRANÇESKU, “Fjalimi për Përkujtimin e përvjetorit të 50^o të themelimit të Sinodit të Ipeshkvijve” (17 tetor 2015).

është besuar dhe cilët janë hapat që Shpirti na fton të kryejmë në mënyrë që të rritemi si Kishë sinodale?

Që ta përballojmë së bashku këtë pikëpyetje, nevojitet që të vihem në dëgjim të Shpirtit Shenjt, që sikurse era “fryn në drejtimin që do; ja dëgjon ushtimën e nuk e di nga vjen e kah shkon” (Gj 3,8), duke qëndruar të hapur ndaj mahnitjeve që me siguri do të përgatitë për ne gjatë rrugës. Kështu aktivizohet një dinamizëm që të mundëson të fillosh të korrësh disa fryte të një kthimi sinodal, të cilat do të piquen gradualisht. Bëhet fjalë për disa fryte të një rëndësie të madhe për cilësinë e jetës kishtarë dhe për përmbushjen e misionit të ungjillëzimit, tek të cilat do të marrin pjesë të gjithë falë Pagëzimit dhe Krezmimit. Më poshtë paraqesim pikat kryesore, të cilat e lakojnë sinodalitetin si formë, si stil dhe si strukturë të Kishës:

- Të përkujtojë sesi Shpirti i ka prirë ecjes së Kishës në histori dhe na thërret sot që të jemi së bashku dëshmitarë të dashurisë së Hyjit;
- Të jetojë një proces kishtar pjesëmarrës dhe gjithëpërfshirës, që i jep secilit – në veçanti atyre që për arsye të ndryshme janë të lënë pas dore – mundësinë për t’u shprehur dhe për të qenë të dëgjuar që të kontribuojnë në ndërtimin e Popullit të Hyjit;
- Të dallojë dhe të çmojë pasuritë dhe varietetet e dhuratave edhe të dhuntive (karizmave) që Shpirti jep në liri, për të mirën e bashkësisë dhe në të mirë të mbarë familjes njerëzore;
- Të sprovtojë mënyra pjesëmarrëse për të ushtruar përgjegjësinë në shpalljen e Ungjillit dhe në angazhimin për të ndërtuar një botë më të bukur dhe më të banueshme;
- Të shqyrtojë sesi në Kishë jetojnë përgjegjësia e pushteti dhe strukturat me të cilat mbarështohen (menaxhohen), duke nxjerrë në pah dhe duke

provuar për t'i kthyer paragjykimet dhe praktikat e shtrembëruara, të cilat nuk janë të rrënjosura në Ungjill;

- Të akreditojë (vlerësojë) bashkësinë e krishterë si subjekt i besueshëm dhe partner besnik në rrugët e dialogut social, shërimit, pajtimit, përfshirjes dhe pjesëmarrjes, rindërtimit të demokracisë, promovimit të vëllazërisë dhe të miqësisë sociale;
- Të rigjenerojë marrëdhëniet mes pjesëtarëve të bashkësisë së krishterë, ashtu sikurse edhe mes bashkësive dhe grupimeve të tjera sociale, si p.sh.: bashkësinë e besimtarëve të religjioneve apo besimeve të tjera fetare, organizatave të shoqërisë civile, lëvizjeve popullore, etj.;
- Të favorizojë vlerësimin dhe përvetësimin e fryteve të përvojave të fundit sinodale në nivel universal, krahinor, kombëtar dhe lokal.

3. Ky Dokument Përgatitor vihet në shërbim të ecjes sinodale, në veçanti si mjet për të favorizuar fazën e parë të dëgjimit dhe të konsultimit të Popullit të Hyjit në Kishat e veçanta (tetor 2021 – prill 2022), me shpresën për të kontribuar që të vihen në lëvizje idetë, energjitë dhe kreativiteti i të gjithë atyre që do të marrin pjesë në itinerar dhe të lehtësojë bashkëndarjen e fryteve të angazhimit të tyre. Për këtë qëllim: 1) nis duke shënuar disa karakteristika të spikatura të kontekstit bashkëkohor; 2) ilustron në mënyrë sintetike referimet teologjike themelore për një mirëkuptim të drejtë dhe zbatim të sinodalitetit; 3) jep disa njohuri biblike që do të mund ta ushqejnë meditimin dhe reflektimin lutës përgjatë ecjes; 4) ilustron disa perspektiva (këndvështrime) nga të cilat të nisësh për të rilexuar përvojat e sinodalitetit të jetuar; 5) paraqet disa pista për ta artikuluar këtë punë rileximi në lutje dhe në bashkëndarje. Për ta

shoqëruar konkretisht organizimin e punëve, propozohet një “*Vademecum*” metodologjik, i cili bashkëngjitet me Dokumentin Përgatitës. Ai është i disponueshëm në sitin e dedikuar³. Siti jep disa burime për ta thelluar temën e sinodalitetit, si mbështetje për këtë Dokument Përgatitës; në mesin e këtyre sinjalizojmë dy prej tyre, të cituara më poshtë disa herë: “*Fjalimin për Përkujtimin e 50° vjetorit të themelimit të Sinodit të Ipeshkvijve*”, i mbajtur nga Papa Françesku me 17 tetor 2015 dhe dokumentin “*Sinodaliteti në jetën dhe në misionin e Kishës*”, i përpunuar nga Komisioni Teologjik Ndërkombëtar dhe i publikuar në vitin 2018.

I. Apeli për të ecur së bashku

4. Ecja sinodale shpaloset në brendësi të një konteksti historik të shënuar nga ndryshime epokale të shoqërisë dhe nga një kalim vendimtar i jetës së Kishës, të cilin nuk është e mundur ta injorosh: në brendësi të kompleksitetit të këtij konteksti, në tensionet dhe kontradiktat e tij, ne jemi të thirrur që “të shqyrtojmë shenjat e kohës dhe t’i interpretojmë ato nën dritën e Ungjillit (GS, nr. 4). Këtu shënohen disa elemente të skenarit global, ngushtësisht të lidhura me temën e Sinodit, porse kuadri do të shkojë duke u pasuruar dhe duke u kompletuar në nivelin lokal.

5. Një tragjedi globale sikurse pandemia nga COVID-19-ta, “në fakt ka ngjallur për një periudhë kohore vetëdijen e të qenit një bashkësi botërore, e cila lundron në të njëjtën barkë, ku e keqja e njërit shkon në dëm të të gjithëve: jemi kujtuar se asnjë nuk shpëton i vetëm, se mund të shpëtojmë vetëm së bashku” (FT, nr. 32). Në të njëjtën kohë, pandemia ka bërë që të shpërthejnë pabarazitë dhe paudhësitë tashmë ekzistuese:

3 Krahi. www.synod.va

njerëzimi duket përherë e më i tronditur nga proceset e masivizimit dhe copëzimit; kushtet tragjike në të cilat jetojnë emigrantët në të gjitha krahinat e botës, dëshmojnë sesa të larta dhe të fuqishme janë akoma pengesat që e ndajnë familjen e vetme njerëzore. Enciklikat “*Laudato si*” (Qofsh lëvduar) dhe “*Fratelli tutti*” (Vëllezër të gjithë) dokumentojnë thellësinë e ndarjeve që përshkojnë njerëzimin dhe atyre analizave mund t’iu referohemi që të vihemi në dëgjim të britmës së të varfërve dhe nga toka të dallojmë shenjat e shpresës së ardhshme, të cilat Shpirti vazhdon t’i lulëzojë edhe në kohën tonë: “Krijuesi nuk na braktis, kurrë s’do të kthehet pas në planin e tij të dashurisë, nuk pendohet se na ka krijuar. Njerëzimi e ka sërish zotësinë të bashkëpunojë për të ndërtuar shtëpinë tonë të përbashkët” (LS, nr. 13).

6. Kjo situatë, e cila edhe pse mes dallimeve të mëdha, bashkon mbarë familjen njerëzore, sfidon aftësitë e Kishës për t’i shoqëruar njerëzit dhe bashkësitë që t’i rilexojnë përvojat e zisë dhe të vuajtjes, të cilat kanë nxjerrë në pah shumë siguri të rreme edhe të kultivojë shpresën dhe fenë në mirësinë e Krijuesit dhe të krijimit të tij. Porse nuk mund t’i fshihemi faktit se vetë Kisha duhet të përballet me mungesën e fesë dhe korrupsionin edhe në brendësi të saj. Në veçanti nuk mund të harrojmë vuajtjen e jetuar nga të miturit dhe njerëzit e pambrojtur “si pasojë e abuzimeve seksuale, të pushtetit dhe të ndërgjegjes, të kryera nga një numër i konsiderueshëm i klerikëve dhe personave të kushtuar”⁴. Vazhdimisht na kërkohet: që “si Populli i Hyjit, të ngarkohemi me dhembjen e vëllezërve tanë të plagosur në mish (trup) dhe në shpirt”⁵: për shumë kohë ajo e viktimave ka qenë një britmë, të cilën Kisha nuk ka ditur ta dëgjojë mjaftueshëm.

4 FRANÇESKU, “*Letra për Popullin e Zotit*” (20 gusht 2018), parathënie

5 Idem, nr. 2

Bëhet fjalë për plagë të thella, që do të mbyllen me shumë vështirësi, për të cilat kurrë s'do lypet mjaftueshëm falje dhe që përbëjnë pengesa, ndonjëherë imponuese, për të përparuar në drejtimin e “të ecurit së bashku”. E gjithë Kisha është e thirrur që të merret me barrën e një kulture të ngopur nga klerikalizmi që trashëgon nga historia e saj dhe me format e ushtrimit të autoritetit mbi të cilat shartohen lloje të ndryshme abuzimi (pushteti, ekonomie, ndërgjegjeje, seksuale). Është i paimagjinueshëm “një kthim i veprimit kishtar pa pjesëmarrjen aktive të të gjithë përbërësve të Popullit të Hyjit”⁶: së bashku t’i kërkojmë Zotit “hirin e kthimit dhe lyerjen e brendshme, që të mund të shprehim, përballë këtyre krimeve të abuzimit, pendesën tonë dhe vendimin tonë për të luftuar me guxim”⁷.

7. Pavarësisht pabesive tona, Shpirti vazhdon të veprojë në histori dhe të dëftojë fuqinë e tij gjallëruese. Pikërisht tek brazdat e gërmuara nga vuajtja e çdo lloji, të pësuar nga familja njerëzore dhe nga Populli i Hyjit, janë duke lulëzuar gjuhë të reja të fesë dhe shtigje të reja në gjendje jo vetëm që t’i interpretojnë ngjarjet nga një pikëpamje teologale, por që të gjejnë tek provat arsyet për të themeluar sërish ecjen e jetës së krishterë dhe kishtarë. Fakti se jo pak Kisha kanë nisur tashmë takime dhe procese konsultimi të Popullit të Hyjit, pak a shumë të strukturuar, është arsye e madhe shprese. Aty ku ato janë shënuar nga një stil sinodal, kuptimi i Kishës ka lulëzuar dhe pjesëmarrja e të gjithëve i ka dhënë një hov të ri jetës kishtarë. Gjithashtu, konfirmohet dëshira për protagonizëm në brendësi të Kishës nga ana e të rinjve dhe kërkesa e një vlerësimi më të madh të grave dhe hapësirave të pjesëmarrjes në misionin e Kishës, tashmë të shënuara nga Asambletë sinodale të vitit 2018 dhe 2019. Në

6 Idem.

7 Idem.

këtë linjë shkojnë edhe themelimi i fundit i shërbesës laikale të katekistit dhe hapja e grave tek mundësia e lektoratit dhe akolitatit.

8. Nuk mund ta injorojmë shumëllojshmërinë e kushteve në të cilat jetojnë bashkësitë e krishtera në krahina të ndryshme të botës. Përbri vendeve në të cilat Kisha pranon shumicën e popullsisë dhe përfaqëson një referim kulturor për mbarë shoqërinë, ka të tjera në të cilat katolikët janë një pakicë; në disa prej këtyre, katolikët së bashku me të krishterë të tjerë, përjetojnë forma persekutimi, nganjëherë edhe shumë të dhunshme dhe jo rrallëherë edhe martirizimi. Nëse nga njëra anë sundon një mentalitet i shekullarizuar që synon ta përjashtojë religjionin nga hapësira publike, nga ana tjetër ekziston një integritet fetar, që nuk e respekton lirinë e tjetrit, ushqen forma intolerance dhe dhune, të cilat pasqyrohen edhe në bashkësitë e krishtera, edhe në marrëdhëniet e saj me shoqërinë. Jo rrallë herë, të krishterët mbajnë të njëjtat qëndrime, duke nxitur edhe në Kishë ndarjet dhe kundërshtitë. Njësoj duhet të kemi parasysh edhe mënyrën sesi jehojnë në brendësi të bashkësive të krishtera dhe në marrëdhëniet e saj me shoqërinë, ndarjet që e përshkojnë këtë të fundit, për arsye etnike, racore, klasore ose të formave të tjera të shtresave sociale apo të dhunës kulturore dhe strukturore. Këto situata kanë një ndikim të thellë mbi kuptimin e shprehjes “të ecim së bashku” dhe mbi mundësitë konkrete për ta zbatuar atë.

9. Në brendësi të këtij konteksti, sinodaliteti paraqet rrugën mësuere për Kishën, e thirrur që të ripërtërihet nën veprimin e Shpirtit dhe falë dëgjimit të Fjalës. Aftësia për të imagjinuar një të ardhme të ndryshme për Kishën dhe për institucionet e saj në lartësinë e misionit të marrë, varet në pjesën më të madhe nga zgjedhja për të filluar procese dëgjimi, dialogu dhe shohitjeje komunitare, tek të cilat të gjithë dhe secili mund të marrë pjesë dhe të kontribuojë.

Në të njëjtën kohë, zgjedhja “për të ecur së bashku” është një shenjë profetike për një familje njerëzore që ka nevojë për një plan të bashkëndarë, e aftë të ndjekë të mirën e të gjithëve. Një Kishë e aftë për bashkim dhe vëllazërim, pjesëmarrje dhe subsidiaritet, në besnikëri ndaj asaj që shpall, mund të rreshtohet përbri të varfërve e të braktisurve dhe t’iu japë atyre zërin e saj. Për të “ecur së bashku” është e domosdoshme që të lihem i edukohemi nga Shpirti ndaj një mentaliteti (mendësie) me të vërtetë sinodal, duke hyrë me guxim dhe liri të zemrës në një proces kthimi pa të cilin nuk do të jetë e mundur ajo “referomë e vazhdueshme në të cilën [Kisha], si një institucion njerëzor dhe tokësor, përherë ka nevojë” (UR, nr. 6; krah EG, nr. 26).

II. Një Kishë thelbësisht sinodale

10. «Ajo që Zoti na kërkon, në një farë kuptimi, tashmë përmbahet tek fjala “Sinod”»⁸, që «është fjalë e vjetër dhe e nderuar në Traditën e Kishës, domethënia e së cilës kujton përmbajtjet më të thella të Zbulimit»⁹. Është «Zoti Jezus që paraqet vetveten si “rruga, e vërteta dhe jeta” (Gj 14,6)» dhe «të krishterët në ndjekjen e tij, janë në zanafillë të quajtur “dishepujt e rrugës” (krah Vap 9,2; 19,9.23; 22,4; 24,11.22)»¹⁰. Në këtë këndvështrim sinodaliteti është shumë më tepër sesa kremtim takimesh kishtarë dhe asamblesh të Ipeshkvijve ose thjesht një çështje administrimi e brendshme e Kishës; ajo «tregon *modus vivendi et operandi* specifike të Kishës, Popull i Hyjit, që dëfton dhe realizon konkretisht të qenit

8 FRANÇESKU, “Fjalimi për Përkujtimin e 50° vjetorit të themelimit të Sinodit të Ipeshkvijve”

9 CTI, “Sinodaliteti në jetën dhe në misionin e Kishës” (2 mars 2018, nr. 3.

10 Idem.

e tij bashkim në ecjen së bashku, në takimet në asamble dhe në pjesëmarrjen aktive të të gjitha gjymtyrëve të saj në misionin e ungjillëzimit»¹¹. Kështu ndërthuren ato që titulli i Sinodit propozon si akse të rëndësishme të një Kise sinodale: bashkim, pjesëmarrje dhe mision. Po ilustrjmë në këtë kapitull, në mënyrë sintetike disa referime teologjike themelore mbi të cilat themelohet kjo perspektivë.

11. Në mijëvjeçarin e parë, “të ecësh së bashku”, d.m.th. të praktikosh sinodalitetin, ka qenë mënyra e zakonshme e të përparuarit të Kishës, e kuptuar si «populli i bashkuar nga njësia e Atit, e Birit dhe e Shpirtit Shenjt»¹². Atyre që e ndanin trupin kishtar, Etërit e Kishës i kanë kundërshtuar bashkimin e Kishës të përhapur nëpër mbarë botën, që shën Agustini e përshkruante si «concordissima fidei conspiratio»¹³, d.m.th. marrëveshja në fe e të gjithë të Pagëzuarve. Këtu rrënjohet zhvillimi i gjerë i një praktike sinodale në të gjitha nivelet e jetës së Kishës – lokale, provinciale, universale – që ka gjetur dëftimin e saj më të lartë tek koncili Ekumenik. Dhe tek ky horizont kishtar, i frymëzuar në fillim nga pjesëmarrja e të gjithëve në jetën kishtarë, që shën Gjon Gojarti mund të thoshte: «Kisha dhe Sinodi janë sinonime»¹⁴. Edhe në mijëvjeçarin e dytë, kur Kisha më së shumti ka nënvizuar funksionin hierarkik, kjo mënyrë e të përparuarit s’që më e vogël: nëse në Mesjetë dhe në epokën moderne krenrimi i sinodeve dioqezane dhe provinciale është i vërtetuar më së miri përbri atyre të koncileve ekumenike, kur bëhej fjalë për të përkufizuar të vërtetat dogmatike dhe papëve iu është dashur të konsultoheshin me Ipeshkvijtë për të ditur besimin e mbarë Kishës, duke apeluar autoritetin e *sensus*

11 Idem, nr. 6.

12 ÇIPRIANI, “*De Oratione Dominica*”, 23: PL 4,553.

13 AGUSTINI, “*Epistola 194*”, 31: PL 33,885.

14 GJON GOJËARTI, “*Explicatio in Psalmum 149*”: PG 55,493.

fidei-t të mbarë Popullit të Hyjit, që është «i pagabueshëm “in credendo”» (EG, nr. 119).

12. Te ky dinamizëm i Traditës është ankoruar Konkili i II-të i Vatikanit. Ai vë në pah se “i pëlqej Hyjit që t’i shenjtërojë dhe t’i shpëtojë njerëzit jo individualisht dhe pas njëfarë lidhjeje mes tyre, por deshi të formonte prej tyre një popull, që ta njihet Hyjin sipas së vërtetës dhe t’i shërbente atij në shenjtëri” (LG, nr. 9). Pjesëtarët e Popullit të Hyjit janë të bashkuar nga Pagëzimi dhe «Megjithëse disa njerëz, për vullnesë të Krishtit janë bërë mësues, shpërndarës të mistereve dhe barinj për të tjerët, gjithsesi, ndër të gjithë ka një barazi të vërtetë për sa i përket dinjitetit dhe veprimit të përbashkët për të gjithë besimtarët në ndërtimin e trupit të Krishtit”. Prandaj të gjithë të Pagëzuarit, pjesëmarrës të funksionit priftëror, profetik dhe mbretëror të Krishtit, «në ushtrimin e shumëllojshëm dhe pasurimin e rregullt të karizmave (dhuntive) të tyre, të thirrjeve të tyre, të shërbesave të tyre»¹⁵, janë subjekte aktive të ungjillëzimit, qoftë individualisht, qoftë si tërësi e Popullit të Hyjit.

13. Konkili ka nënvizuar sesi falë virtytit të lyerjes së Shpirtit Shenjt të marrë në Pagëzim, tërësia e Besimtarëve “nuk mund të gabohet në besim dhe e shfaq këtë pronësi të tij nëpërmjet kuptimit mbinatyror të fesë së të gjithë popullit, kur “prej Ipeshkvijve deri tek besimtarët e fundit laikë”, tregon pranimin e vet të gjithmbarshëm në gjërat e fesë dhe të moralit” (LG, nr. 12). Është Shpirti që u prin besimtarëve “kah e gjithë e vërteta” (Gj 16,13). Falë veprës së tij, «Kjo Traditë me origjinë apostolike përparon në Kishë», që i gjithë populli i shenjtë i Hyjit të rritet në mirëkuptimin dhe në përvojën «si të gjërave, ashtu edhe të fjalëve të përçuara qoftë me soditjen dhe me studimin e besimtarëve që i meditojnë në zemrat e tyre (krah Lk 2,19), qoftë me inteligjencën e dhënë nga një përvojë më e thellë e gjërave shpirtërore, qoftë prej

15 CTI, “Sinodaliteti në jetën dhe në misionin e Kishës”, nr. 6.

predikimit të atyre, të cilët me pasardhësin ipeshkvnor kanë marrë një karizmë të sigurt të së vërtetës» (DV, nr. 8). Në fakt, ky Popull qëndron vazhdimisht në mësimin e Apostujve, në bashkimin vëllazëror, në ndarjen e bukës dhe në lutje, «në mënyrë që, mbajtja, zbatimi dhe dëshmimi i fesë së përcuar, të vendoset mes barinjve dhe besimtarëve si një njësi shpirti e posaçme» (DV, nr. 10).

14. Barinjtë, të caktuar prej Hyjit si “rojtare të vërtetë, interpretues dhe dëshmitarë të fesë së mbarë Kishës”¹⁶, prandaj nuk kanë frikë që të vihen në dëgjim të Grigiës që iu është besuar atyre: konsultimi i popullit të Hyjit nuk do të thotë që në brendësi të Kishës të marrësh dinamizmin e demokracisë të përqendruar tek parimi i shumicës, sepse në bazë të pjesëmarrjes së çdo procesi sinodal është pasioni i bashkëndarë për misionin ungjillëzues të përbashkët dhe jo përfaqësimi i interesave në konflikt. Me fjalë të tjera, bëhet fjalë për një proces kishtar që nuk mund të realizohet tjetër kund veçse “në gjirin e një bashkësie hierarkisht të strukturuar”¹⁷. Dhe në lidhjen e frytshme mes *sensus fidei*-t të Populli të Hyjit dhe funksionit të magjisterit të Barinjve, realizohet pëlqimi unanim i krejt Krishës në të njëjtën fe. Çdo proces sinodal, në të cilin Ipeshkvijtë janë të thirrur që të shoshitin atë që Shpirti i thotë Kishës, jo të vetëm, por duke dëgjuar popullin e Hyjit, që “merr pjesë edhe në zyrën profetike të Krishtit” (LG, nr. 12), është formë e dukshme e asaj “ecjeje së bashku” që e bën Kishën të rritet. Shën Benedikti nënvizon sesi “shpesh Zoti i zbulon vendimin më të mirë”¹⁸ atij që nuk zë pozicione të spikatura në bashkësi (në atë rast më i riu); kështu, Ipeshkvijtë të kenë kujdes që t’i arrijnë të gjithë, që në

16 FRANÇESKU, “Fjalimi për Përkujtimin e 50° vjetorit të themelimit të Sinodit të Ipeshkvijve.”

17 CTI, “Sinodaliteti në jetën dhe në misionin e Kishës”, nr. 60.

18 S. BENEDICTI, “Regula” III, 3.

zhvillimin e rregullt të ecjes sinodale të realizohet porosia e apostullit Pal për bashkësitë: “Mos e pengoni Shpirtin Shenjt të veprojë në ju! Profecitë mos i përbuzni! Çdo gjë shqyrtoni me kujdes: mbani të mirën!” (1Sel 5,19-21).

15. Kuptimi i ecjes tek e cila jemi të thirrur të gjithë, para së gjithash është që të zbulojmë fytyrën dhe formën e një Kisha sinodale, në të cilën «secili ka diçka për të mësuar. Populli besnik, Kolegji ipeshkvor, Ipeshkëvi i Romës: njëri në dëgjim të tjetrit dhe të gjithë në dëgjim të Shpirtit Shenjt, “Shpirtit të së vërtetës” (Gj 14,17), për të njohur atë që Ai “iu thotë Kishave” (Vap 2,7)»¹⁹. Ipeshkëvi i Romës, porsi fillim dhe themel njësie i Kishës, iu kërkon të gjithë Ipeshkvijve dhe të gjitha Kishave të veçanta, në të cilat dhe duke u nisur prej të cilave ekziston një Kishë katolike e vetme (krah LG, nr. 23), që të hynë me besim dhe guxim në ecjen e sinodalitetit. Në këtë “ecje së bashku”, le t’i kërkojmë Shpirtit që të na zbulojë sesi bashkimi, i cili përmbledh në një njësi shumëllojshmërinë e dhuratave, të karizmave (dhuntive), të shërbesave (ministereve) të jetës për misionin: një Kishë sinodale është një Kishë “në dalje”, një Kishë misionare, “me dyer të hapura” EG, nr. 46). Kjo gjë përfshin thirrjen për t’i thelluar marrëdhëniet me Kishat e tjera dhe bashkësitë e krishtera, me të cilat jemi të bashkuar nga një Pagëzim i vetëm. Më pas, perspektiva e “ecjes së bashku” është akoma më e gjerë dhe përqafon mbarë njerëzimin, me të cilin bashkëndajmë “gëzimet dhe shpresat, trishtimet dhe ankthet” (GS, nr. 1). Një Kishë sinodale është një shenjë profetike, në veçanti për një bashkësi të kombeve të paafra për të propozuar një plan të bashkëndarë, nëpërmjet të cilit të mund të ndjekë të mirën e të gjithëve: sot, për Kishën, të zbatosh sinodalitetin është mënyra më e dukshme për të

19 FRANÇESKU, “Fjalimi për Përkujtimin e 50° vjetorit të themelimit të Sinodit të Ipeshkvijve.”

qenë “sakramenti i gjithmbarshëm i shpëtimit” (LG, nr. 48), “shenja dhe mjete i bashkimit intim me Hyjin dhe i njësisë së krejt gjinisë njerëzore” (LG, nr. 1).

III. Në dëgjim të Shkrimeve

16. Shpirti i Hyjit që ndriçon dhe gjallëron këtë “ecje së bashku” të Kishave, është i njëjti me atë që vepron në misionin e Jezusit, i cili iu është premtuar Apostujve dhe brezave të dishepujve që e dëgjojnë Fjalën e Hyjit dhe e zbatojnë atë. Shpirti, sipas premtimit të Zotit, nuk kufizohet në konfirmimin e vazhdimësisë së Ungjillit të Jezusit, por do të ndriçojë thellësitë gjithnjë e më të reja të Zbulesës së tij dhe do të frymëzojë vendimet e nevojshme për të mbështetur ecjen e Kishës (krah. Gj 14,25-26); 15,26-27; 16,12-15). Për këtë nevojitet që ecja jonë e ndërtimit të një Kise sinodale, të frymëzohet nga dy “imazhe” të Shkrimit të Shenjtë. Njëra shfaqet në përfaqësimin e “skenës së bashkësisë” që shoqëron vazhdimisht rrugën e ungjillëzimit; tjetra i referohet përvojës së Shpirtit, në të cilën Pjetri dhe bashkësia primitive njohin rrezikun e vendosjes së kufijve të pajustificuar në bashkëndarjen e besimit. Përvoja sinodale e të ecurit së bashku, në ndjekjen e Zotit dhe në bindjen ndaj Shpirtit, do të mund të marrë një frymëzim vendimtar nga meditari i këtyre dy momenteve të Zbulesës.

Jezusi, turma, apostujt

17. Në strukturën e tij themelore, një skenë origjinale shfaqet si vazhdimësia e mënyrës nëpërmjet së cilës Jezusi zbulohet përgjatë gjithë Ungjillit, duke shpallur ardhjen e Mbretërisë së Hyjit. Aktorët e përfshirë në thelb janë tre (plus

një). Sigurisht, i pari është Jezusi, protagonisti absolut që merr iniciativën, duke mbjellë fjalët dhe shenjat e ardhjes së Mbretërisë pa bërë “preferencë për personat” (krah. Vap 10,34). Në forma të ndryshme, Jezusi i kushton vëmendje të veçantë të “ndarëve” nga Hyji dhe “të braktisurve” nga bashkësia (mëkatarët dhe të varfrit, në gjuhën e Ungjillit). Me fjalët dhe veprimet e tij, Ai ofron çlirim nga e keqja dhe shndërrim në shpresë, në emër të Hyjit Atë dhe në fuqinë e Shpirtit Shenjt. Me gjithë larminë e thirrjeve dhe përgjigjeve mikpritëse të Zotit, tipari i përbashkët është se besimi shfaqet gjithmonë si një vlerësim i personit: lutja e tij dëgjohej, në vështirësi ndihmohet, gatishmëria e tij vlerësohet, dinjiteti i tij konfirmohet nga vështrimi i Hyjit dhe i rikthehet mirënjohja në bashkësi.

18. Veprimi i ungjillëzimit dhe mesazhi i shpëtimit, në fakt, nuk do të kuptoheshin pa hapjen e vazhdueshme të Jezusit ndaj bashkëbiseduesit më të gjerë të mundshëm, të cilin Ungjijtë e tregojnë si *turmë*, domethënë tërësia e njerëzve që e ndjekin atë përgjatë rrugës dhe ndonjëherë ata madje e ndjekin me shpresën e një shenje dhe të një fjale shpëtimi: ky është aktori i dytë në skenën e Zbulesës. Shpallja ungjillore nuk i drejtohet vetëm disa të shkolluarve ose të zgjedhurve. Bashkëbiseduesi i Jezusit është “populli” i jetës së përbashkët, “kushdo” i gjendjes njerëzore, të cilët Ai i vë drejtpërdrejt në kontakt me dhuratën e Zotit dhe me thirrjen për shpëtim. Në një mënyrë që i befason dhe nganjëherë i shkandullon dëshmitarët, Jezusi pranon si bashkëbisedues të tij të gjithë ata që dalin nga turma: ai dëgjon ankesat pasionante të gruas kananease (krah. Mt 15,21-28), e cila nuk mund ta pranojë të përjashtohet nga bekimi që Ai sjell; Ai i lejon vetes të dialogojë me gruan samaritane (krah. Gj 4,1-42), pavarësisht nga gjendja e saj si një grua e komprometuar shoqërisht dhe fetarisht; kërkon aktin e fesë së lirë dhe mirënjohëse të njeriut që kishte lindur i verbër (krah. Gj 9), të

cilin feja zyrtare e kishte hedhur poshtë si të jashtëligjshëm në perimetrin e hirit.

19. Disa e ndjekin Jezusin në mënyrë më të drejtpërdrejtë, duke përjetuar besnikërinë e dishepullimit, ndërsa të tjerët janë të ftuar të kthehen në jetën e tyre të zakonshme: megjithatë, të gjithë dëshmojnë fuqinë e besimit që i ka shpëtuar (krh. Mt 15,28). Midis atyre që ndjekin Jezusin, vihet në dukje figura e *apostujve*, të cilët Ai vetë i thërret që në fillim, duke i caktuar drejt një ndërmjetësimi autoritar të marrëdhënies së turmës me Zbulesën dhe me ardhjen e Mbretërisë së Hyjit. Hyrja e këtij aktori të tretë në skenë nuk ndodh falë një shërimi ose kthimi, por përkon me thirrjen e Jezusit. Zgjedhja e apostujve nuk është privilegj i një pozicioni ekskluziv të pushtetit dhe të ndarjes, por hiri i një shërbese gjithëpërfshirëse bekuese dhe bashkësiore. Falë dhuratës së Shpirtit të Zotit të ringjallur, ata duhet ta ruajnë vendin e Jezusit, pa e zëvendësuar atë: jo për t'i vënë filtra pranisë së tij, por për ta lehtësuar takimin me të.

20. Jezusi, turma në larminë e saj, apostujt: ja imazhi dhe misteri që duhet soditur dhe thelluar vazhdimisht, në mënyrë që Kisha të bëhet gjithnjë e më shumë ajo që është. Asnjëri prej të tre aktorëve nuk mund të largohet nga skena. Nëse mungon Jezusi dhe dikush tjetër vihet në vendin e tij, Kisha bëhet një kontratë midis apostujve dhe turmës, dialogu i të cilëve të çon të ndjekësh komplotin e lojës politike. Pa apostujt, të autorizuar nga Jezusi dhe të udhëzuar nga Shpirti, raporti me të vërtetën ungjillore ndërpritet dhe turma mbetet e ekspozuar ndaj një miti ose një ideologjie rreth Jezusit, pavarësisht nëse e mirëpresim ose e refuzojmë atë. Pa turmën, marrëdhënia e apostujve me Jezusin kthehet në një formë sekti edhe autoreferenciale të fetarisë dhe ungjillëzimi humbet dritën e tij, e cila buron nga zbulesa e vetes, që Hyji ia drejton kujtdo, drejtpërdrejt, duke i ofruar shpëtimin e tij.

21. Pastaj është aktori “ekstra”, antagonisti, i cili sjell ndarjen djallëzore të tre të tjerëve në skenë. Përballë perspektivës shqetësuese të kryqit, ka dishepuj që largohen dhe turma që ndryshojnë gjendjen e tyre. Kurthi që ndan - dhe për këtë arsye bie ndesh me një ecje të përbashkët - shfaqet në mënyrë indiferente në format e ashpërsisë fetare, të urdhrit moral që paraqitet si më kërkues se ai i Jezusit dhe i joshjes së një urtësie politike shekullore (mondane), që dëshiron të jetë më efektive sesa një shoshitje e shpirtrave. Për të shpëtuar nga mashtrimet e “aktorit të katërt” nevojitet një kthim i vazhdueshëm. Emblematik në këtë drejtim është episodi i centurionit Kornel (shih Vap 10), paraardhës i atij “koncili” të Jerusalemit (shih Vap 15), i cili përbën një pikë referimi vendimtare për një Kishë sinodale.

Një dinamikë e dyfishtë e konvertimit: Pjetri dhe Korneli (Vap 10)

22. Episodi para së gjithash tregon kthimin e Kornelit, i cili madje merr një lloj lajmi. Korneli është një pagan, me sa duket romak, centurion (oficer i rangut të ulët) i ushtrisë pushtuese, i cili ushtron një zanat të bazuar në dhunë dhe abuzim. Megjithatë, ai i kushtohet lutjes dhe lëmoshës, domethënë, ai kultivon marrëdhënien me Zotin dhe kujdeset për të afërmin e tij. Pikërisht tek ai, çuditërisht hyn engjëlli, e thërret për emër dhe e nxit të dërgojë - folja e misionit! - shërbëtorët e tij në Jope për të thirrur - folja e vokacionit! - Pjetrin. Kështu tregimi bëhet ai i kthimit të këtij të fundit, i cili atë ditë pati një vegim, ku një zë e urdhëroi të vriste dhe të hante kafshë, disa prej të cilave të papastra. Përgjigja e tij është vendimtare: “Kurrësesi o Zot” (Vap 10,14). Ai e pranon se është Zoti që po i flet, por e kundërshton me një refuzim të qartë, sepse ai urdhër shemb ligjet e Torah-ut që janë të

pamohueshme për identitetin e tij fetar, të cilat shprehin një mënyrë për të kuptuar zgjedhjet si një ndryshim që përfshin ndarje dhe përjashtim nga popujt e tjerë.

23. Apostulli mbetet thellësisht i shqetësuar dhe ndërsa e pyet veten për kuptimin e asaj që i ka ndodhur, vijnë njerëzit e dërguar nga Korneli, të cilët Shpirti ia tregojnë si të dërguarit e tij. Pjetri u përgjigjet atyre me fjalë që të kujtojnë ato të Jezusit në kopsht: “Unë jam ai që kërkoni” (Vap10,21). Është me të vërtetë një kthim, një hap i dhembshëm dhe jashtëzakonisht i frytshëm daljeje nga kategoritë e tij kulturore dhe fetare: Pjetri pranon të hajë së bashku me paganët ushqimin që ai e kishte konsideruar gjithmonë të ndaluar, duke e njohur atë si një instrument të jetës dhe të bashkimit me Hyjin dhe me të tjerët. Dhe në takim me njerëzit, duke i pranuar, duke ecur bashkë me ta dhe duke hyrë në shtëpitë e tyre, e kupton domethënien e vegimit të tij: asnjë qenie njerëzore nuk është e padenjë në sytë e Zotit dhe ndryshimi i krijuar nga zgjedhja nuk është një preferencë ekskluzive, por shërbim dhe dëshmi e një fryme universale.

24. Si Korneli ashtu edhe Pjetri përfshijnë në rrugën e tyre të kthimit njerëz të tjerë, duke u bërë shokë rruge me ta. Veprimi apostolik realizon vullnetin e Hyjit duke krijuar bashkësi, duke shembur gardhet dhe duke promovuar takimin. Fjala luan një rol qendror në takimin midis dy protagonistëve. Korneli fillon të ndajë përvojën që ka jetuar. Pjetri e dëgjon atë dhe pastaj e merr ai vetë fjalën, duke komunikuar atë që i ndodhi dhe duke dëshmuar afërsinë e Zotit, i cili i shkon në takim çdo personi duke e çliruar nga ajo që e bën rob të së keqes dhe vret njerëzimin (krah. Vap 10,38). Kjo mënyrë komunikimi është e ngjashme me atë që Pjetri do të përdorë në Jerusalem, kur besimtarët e rrethprerë do ta qortojnë, duke e akuzuar se ka thyer normat tradicionale, në të cilat duket se përqendrohet e gjithë vëmendja e tyre, duke e lënë pas dore Shpirtin: “Ke hyrë në shtëpinë e parrethprerëve dhe ke ngrënë me ta!” (Vap

11, 3). Në atë moment konflikti, Pjetri tregon atë që i ndodhi dhe reagimet e tij çatrafiluese, turbulluese dhe rezistuese. Pikërisht kjo do t'i ndihmojë bashkëbiseduesit e tij, fillimisht agresivë dhe refraktarë, që ta dëgjojnë dhe ta pranojnë atë që ka ndodhur. Shkrimi Shenjt do të kontribuojë në interpretimin e kuptimit të tij, siç do të ndodhë më vonë p.sh. edhe në “koncilin” e Jerusalemit, në një proces shoshitjeje që është një dëgjim i Shpirtit në bashkësi.

IV. SINODALITETI NË VEPRIM: RRUGËT PËR T’U KONSULTUAR ME POPULLIN E ZOTIT

25. E ndriçuar nga Fjala dhe e themeluar në Traditën, ecja sinodale rrënjohet në jetën konkrete të Popullit të Hyjit. Në fakt, ajo paraqet një veçori e cila është gjithashtu një burim i jashtëzakonshëm: objekti i saj - sinodaliteti - është gjithashtu metoda e saj. Me fjalë të tjera, ajo përbën një lloj kantieri ose projekti pilot, e cila i lejon t’i korrë menjëherë frytet e dinamizmit që kthimi progresiv sinodal fut në komunitetin e krishterë. Nga ana tjetër, ajo nuk mund t’i referohet vetëm përvojave të sinodalitetit të jetuar në nivele të ndryshme dhe me shkallë të ndryshme intensiteti: pikat e forta dhe sukseset e tyre, ashtu sikurse edhe kufizimet dhe vështirësitë e tyre, ofrojnë elemente të çmuara të shoshitjes rreth drejtimit për të vazhduar ecjen. Sigurisht, këtu i referohemi përvojave të aktivizuara nga ecja sinodale e tanishme, por edhe të gjitha atyre në të cilat tashmë përjetohen forma të së “ecurit së bashku” në jetën e zakonshme edhe kur termi sinodalitet as që njihet apo përdoret.

Pyetja themelore

26. Pyetja themelore që e udhëheq këtë konsultë të Popullit të Hyjit, siç është përmendur tashmë në fillim, është sa vijon:

Një Kishë sinodale, që shpall Ungjillin, “ecën së bashku”: Si realizohet kjo “ecje së bashku” sot në Kishën tuaj të veçantë? Cilët janë hapat që Shpirti na fton të ndërmarrim për t’u rritur në “ecjen së bashku”?

Për t’iu përgjigjur jeni të ftuar të:

- a) Të pyeteni se cilat përvoja të Kishës suaj të veçantë ju sjell në mendje pyetja themelore;
- b) Të rilexoni këto përvoja më në thellësi: farë gëzimesh provokuan? Çfarë vështirësish dhe pengesash kanë ndeshur? Çfarë plagësh nxorën? Çfarë njohurish ngjallën?
- c) Të mbledhësh frytet që duhen ndarë: Ku kumbon zëri i Shpirtit në këto përvoja? Çfarë po na kërkon? Cilat janë pikat që duhen konfirmuar, perspektivat për ndryshim, hapat që duhen ndërmarrë? Ku vërejmë një pëlqim? Cilat shtigje hapen për Kishën tonë të veçantë?

Artikulime të ndryshme të sinodalitetit

27. Në lutjen, reflektimin dhe bashkëndarjen e ngjallur nga pyetja themelore, është mirë të mbahen parasysh tri nivele mbi të cilat artikullohet sinodaliteti si “dimensioni përbërës i Kishës”²⁰:

- plani i stilit me të cilin Kisha jeton dhe punon zakonisht, që shpreh natyrën e Popullit të Hyjit, i cili ecën së bashku dhe mbledhet në një asamble të thirrur

20 CTI, “Sinodaliteti në jetën dhe në misionin e Kishës”, nr. 70.

nga Zoti Jezus në fuqinë e Shpirtit të Shenjtë për të shpallur Ungjillin. Ky stil arrihet përmes “dëgjimit bashkësior të Fjalës dhe kremtimit të Eukaristisë, vëllazërisë së bashkimit dhe bashkëpërgjegjesisë e pjesëmarrjes së të gjithë Popullit të Hyjit, në nivelet e tij të ndryshme dhe në dallimin e shërbesave dhe roleve të ndryshme, për jetën dhe misionin e saj”²¹;

- plani i strukturave dhe proceseve kishtare, të përcaktuara edhe nga pikëpamja teologjike dhe kanonike, në të cilin natyra sinodale e Kishës shprehet në mënyrë institucionale në nivelin lokal, rajonal dhe universal;
- plani i proceseve dhe ngjarjeve sinodale në të cilat Kisha thirret nga autoriteti kompetent, sipas procedurave specifike të përcaktuara nga disiplina kishtare.
- Edhe pse të ndryshme nga pikëpamja logjike, këto tri plane i referohen njëri-tjetrit dhe duhet të mbahen së bashku në një mënyrë koherente, përndryshe transmetohet një kundër-dëshmi dhe besueshmëria e Kishës minohet. Në fakt, nëse nuk mishërohet në struktura dhe procese, stili i sinodalitetit degradon lehtë nga rrafshi i synimeve dhe i dëshirave ndaj atij të retorikës, ndërsa proceset dhe ngjarjet, nëse nuk janë të gjallëruara nga një stil i duhur, rezultojnë formalitete boshe.

28. Për më tepër, në rileximin e përvojave, është e nevojshme të mbahet parasysh se “të ecurit së bashku” mund të kuptohet nga dy këndvështrime të ndryshme, të ndërlidhura fort. E para e shikon jetën e brendshme të Kishave të veçanta, marrëdhëniet midis subjekteve që i përbëjnë ato (në radhë të parë ato midis Besimtarëve dhe Barinjve të tyre, gjithashtu përmes organizmave pjesëmarrëse të parashikuara nga

21 Idem.

disiplina kanonike, përfshirë këtu sinodin dioqezan) dhe në bashkësitë në të cilat ato janë të ndara (në veçanti famullitë). Pastaj shqyrton marrëdhëniet e Ipeshkvijve midis tyre dhe me Ipeshkëvin e Romës, gjithashtu përmes organeve të ndërmjetme të sinodalitetit (Sinodet e Ipeshkvijve të Kishave Patriarkale dhe Arqipeshkvore të larta, Këshillat e Hierarkëve dhe Asamblëtë e Hierarkëve të Kishave *sui iuris*, Konferencat Ipeshkvnore, me shprehjet e tyre kombëtare, ndërkombëtare dhe kontinentale). Prandaj shtrihet në mënyrën në të cilën çdo Kishë e veçantë integron brenda vetes kontributin e formave të ndryshme të jetës monastike, fetare dhe të kushtuar, të shoqatave dhe lëvizjeve laike, të institucioneve të kishës dhe kishtarë të llojeve të ndryshme (shkolla, spitale, universitete, fondacione, organizatat e bamirësisë dhe ndihmës, etj.). Së fundmi, kjo perspektivë përfshin gjithashtu edhe marrëdhëniet dhe nismat e përbashkëta me vëllezërit dhe motrat e Rrëfimeve të tjera të Krishtera, me të cilët ne ndajmë dhuratën e të njëjtit Pagëzim.

29. Perspektiva e dytë merr parasysh sesi Populli i Hyjit ecën së bashku me të gjithë familjen njerëzore. Kështu shikimi do të ndalet në gjendjen e marrëdhënieve, dialogut dhe çdo iniciative të përbashkët me besimtarët e feve të tjera, me njerëzit larg besimit, si dhe me mjedise dhe grupe të veçanta shoqërore, me institucionet e tyre (bota e politikës, kulturës, ekonomisë, financës, punës, sindikatat dhe shoqatat e firmave, organizatat joqeveritare dhe të shoqërisë civile, lëvizjet popullore, pakicat e llojeve të ndryshme, të varfrit dhe të përjashtuarit, etj.).

Dhjetë bërthama tematike për t'u thelluar

30. Për të ndihmuar në nxjerrjen e përvojave dhe për të kontribuar më shumë në konsultim, tregojmë këtu më

poshtë dhjetë bërthama tematike që artikulojnë aspekte të ndryshme të “sinodalitetit të jetuar”. Ato do të përshtaten me kontekstet e ndryshme lokale dhe herë pas here do të integrohen, shpjgohen, thjeshtohen, thellohen, duke siguruar vëmendjen e veçantë për atë që ka më shumë vështirësi pjesëmarrjeje dhe përgjigjeje: *Vademecum*-i që e shoqëron këtë Dokument Përgatitor ofron në këtë drejtim mjete, shtigje dhe sugjerime në mënyrë që grupet e ndryshme të pyetjeve të frymëzojnë konkretisht momente lutjeje, formimi, reflektimi dhe shkëmbimi.

I. SHOKËT E UDHËS

Në Kishë dhe në shoqëri jemi në të njëjtën rrugë krah për krah. Në Kishën tuaj lokale, cilët janë ata që “ecin së bashku”? Kur themi “Kisha jonë”, kush është pjesë e saj? Kush na kërkon të ecim së bashku? Cilët janë shokët e udhëtimit edhe jashtë perimetrit kishtar? Cilët njerëz ose grupe lihen mënjanë, shprehimisht apo në fakt?

II. TË DËGJOSH

Dëgjimi është hapi i parë, por kërkon një mendje dhe zemër të hapur, pa paragjykime. Kundrejt kujt “është borxhlie në dëgjim” Kisha jonë e veçantë? Si dëgjohen laikët, veçanërisht të rinjtë dhe gratë? Si e integrojmë kontributin e grave dhe burrave të kushtuar? Çfarë hapësire ka zëri i pakicave, të mënjanuarve dhe të përjashtuarve? A mund t'i identifikojmë paragjykimet dhe stereotipat që e pengojnë dëgjimin tonë? Si e dëgjojmë kontekstin social dhe kulturor në të cilin jetojmë?

III. TË MARRËSH FJALËN

Të gjithë janë të ftuar të flasin me guxim dhe sinqeritet, domethënë duke integruar lirinë, të vërtetën dhe bamirësinë. Si e promovojmë brenda komunitetit dhe organizatave

një stil komunikimi të lirë dhe autentik pa hipokrizi dhe oportunitizëm? Po në lidhje me shoqërinë që i përkasim? Kur dhe si arrijmë të themi atë që është e rëndësishme për ne? Si funksionon marrëdhënia me sistemin e mediave (jo vetëm ato katolike)? Kush flet në emër të bashkësisë së krishterë dhe si zgjidhet ai?

IV. TË KREMTOSH

“Të ecësh së bashku” është e mundur vetëm nëse bazohet në dëgjimin e përbashkët të Fjalës dhe në krentrimin e Eukaristisë. Si e frymëzojnë dhe e udhëheqin në të vërtetë “ecjen së bashku” lutja dhe krentrimi liturgjik? Si i frymëzojnë vendimet më të rëndësishme? Si e promovojmë pjesëmarrjen aktive të të gjithë Besimtarëve në liturgji dhe ushtrimin e funksionit të shenjtërimin? Çfarë hapësire i jepet ushtrimit të shërbesave të lektoratit dhe akolitit?

V. BASHKËPËRGJEGJËS NË MISION

*Sinodaliteti është në shërbim të misionit të Kishës, në të cilin të gjithë anëtarët e saj janë të thirrur të marrin pjesë. Meqenëse të gjithë jemi dishepuj misionarë, si ftohet çdo person i Pagëzuar të jetë protagonist i misionit? Si i mbështet bashkësia anëtarët e saj të angazhuar në një shërbim në shoqëri (angazhim social dhe politik, në kërkimin shkencor dhe mësimdhënien, në promovimin e drejtësisë sociale, në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe në kujdesin e Shtëpisë së përbashkët, etj.)? Si i ndihmon ata t’i jetojnë këto angazhime në një logjikë misioni? Si bëhet shoshitja në zgjedhjet relative mbi misionin dhe kush merr pjesë në të? Si janë integruar dhe përshtatur traditat e ndryshme mbi temën e stilit sinodal, të cilat përbëjnë trashëgiminë e shumë Kishave, veçanërisht atyre lindore, në funksion të një dëshmie të krishterë efektive? Si funksionon bashkëpunimi në territoret ku gjenden Kisha të ndryshme *sui iuris*?*

VI. TË DIALOGOSH NË KISHË DHË NË SHOQËRI

Dialogu është një ecje qëndrueshmërie që përfshin heshtje dhe vuajtje, por i aftë të mbledhë përvojën e personave dhe popujve. Cilat janë vendet dhe mënyrat e dialogut brenda Kishës sonë të veçantë? Si përballen divergjencat e vizionit, konfliktet, vështirësitë? Si e promovojmë bashkëpunimin me Dioqezat fqinje, me dhe mes bashkësive fetare të pranishme në zonë, me dhe midis shoqatave dhe lëvizjeve laike, etj.? Çfarë përvojash të dialogut dhe angazhimit të përbashkët vazhdojmë me besimtarët e feve të tjera dhe me ata që nuk besojnë? Si dialogon dhe mëson Kisha nga realitetet e tjera shoqërore: bota e politikës, ekonomisë, kulturës, shoqërisë civile, të varfrit ...?

VII. ME KONFESIONET E TJERA TË KRISHTERA

Dialogu midis të krishterëve të konfesioneve të ndryshme, të bashkuar nga një Pagëzim, ka një vend të veçantë në ecjen sinodale. Çfarë marrëdhëniesh kemi me vëllezërit dhe motrat e Konfesioneve të tjera të krishtera? Cilat fusha kanë të bëjnë me to? Çfarë frytësh kemi nxjerrë nga kjo “ecje së bashku”? Cilat janë vështirësitë?

VIII. AUTORITET DHE PJESËMARRJE

Një Kishë sinodale është një Kishë pjesëmarrëse dhe bashkëpërgjegjëse. Si i identifikoni objektivat që duhen ndjekur, mënyrën e arritjes së tyre dhe hapat që duhen ndërmarrë? Si ushtrohet autoriteti brenda Kishës sonë të veçantë? Cilat janë praktikat e punës në ekip dhe në bashkëpërgjegjësi? Si promovohen shërbesat laike dhe marrja e përgjegjësisë nga Besimtarët? Si funksionojnë organizmat e sinodalitetit në nivelin e Kishës së veçantë? A janë ato një përvojë e frytshme?

IX. TË SHOSHITËSH DHE TË VENDOSËSH

*Në një stil sinodal, vendoset nëpërmjet shoshitjes, në bazë të një pëlqimi që buron nga bindja e përbashkët ndaj Shpirtit. Me cilat procedura dhe me cilat metoda shoshitim së bashku dhe marrim vendime? Si mund të përmirësohen ato? Si e promovojmë pjesëmarrjen në vendime në gjirin e bashkësive hierarkisht të strukturuar? Si e artikulojmë fazën konsultuese me atë këshilluese, procesin e *decision-making* (procesit të vendimmarrjes) me momentin e *decision-taking* (vendimmarrjes)? Si dhe me cilat mjete e promovojmë transparencën dhe *accountability*-n (llogaridhënien)?*

X. TË FORMOHESH PËR SINODALITETIN

Përshpirtëria e të ecurit së bashku është e thirrur të bëhet një parim edukativ për formimin e personit njerëzor dhe të krishterë, të familjeve dhe bashkësive. Si i trajnojmë njerëzit, veçanërisht ata që mbajnë role përgjegjësie brenda bashkësisë së krishterë, për t'i bërë ata më të aftë të “ecin së bashku”, të dëgjojnë njëri-tjetrin dhe të dialogojnë? Çfarë formimi ofrojmë për shoshitjen dhe ushtrimin e autoritetit? Cilat mjete na ndihmojnë të lexojmë dinamikën e kulturës në të cilën jemi zhytur dhe ndikimin e tyre në stilin tonë të Kishës?

Për të kontribuar në konsultim

31. Qëllimi i fazës së parë të udhëtimit sinodal është nxitja e një procesi të gjerë konsultimi për të mbledhur pasurinë e përvojave të sinodalitetit të jetuar, në artikulet dhe aspektet e tyre të ndryshme, duke përfshirë Barinjtë dhe Besimtarët e Kishave të veçanta krejtësisht të ndryshme nivelet, përmes mjeteve më të përshtatshme sipas realiteteve të veçanta lokale: konsultimi, i koordinuar nga Ipeshkëvi, i

drejtohet “Priftërinjve, Diakonëve dhe Besimtarëve laikë të Kishave të tyre, si individualisht ashtu edhe së bashku, pa lënë pas dore kontributin e çmuar që mund të vijë nga burra dhe gra të Kushtuara” (EC, nr. 7). Në veçanti, kërkohet kontributi i organizatave pjesëmarrëse të Kishave të veçanta, veçanërisht Këshillit Presbiterial dhe Këshillit Baritor, nëpërmjet të cilëve “një Kishë sinodale mund të fillojë të formohet”²² me të vërtetë. Po aq do të jetë i vlefshëm kontributi i realiteteve të tjera kishtarë, të cilave do t’iu dërgohet Dokumenti Përgatitor, si dhe ai i atyre që duan të dërgojnë drejtpërdrejt të tyre. Së fundmi, do të jetë me rëndësi themelore që zëri i të varfërve dhe të përjashtuarve të gjejë hapësirë, jo vetëm i atyre që kanë një rol ose përgjegjësi brenda Kishave të veçanta.

32. Sinteza që secila Kishë e veçantë do të përpunojë në fund të kësaj pune dëgjimi dhe shoshitjeje do të përbëjë kontributin e saj në udhëtimin e Kishës universale. Për t’i bërë fazat pasuese të udhëtimit më të lehta dhe më të qëndrueshme, është e rëndësishme që të jeni në gjendje t’i kondensoni frytet e lutjes dhe të reflektimit në një maksimum prej dhjetë faqesh. Nëse është e nevojshme për t’i kontekstualizuar dhe shpjeguar ato më mirë, mund të bashkëngjiten tekste të tjera mbështetëse ose plotësuese. Kujtojmë se qëllimi i Sinodit dhe i këtij konsultimi nuk është të prodhojë dokumente, por “të bëjë që ëndrrat të mbijnë, të ngjallen profeci dhe vegime, të lulëzojnë shpresat, të stimulohet besimi, të lidhen plagët, të thuren marrëdhënie, të ringjallet një agim shprese, për të mësuar njëri nga tjetri dhe për të krijuar një imagjinatë pozitive që ndriçon mendjet, ngroh zemrat, iu kthen forcën duarve”²³.

22 FRANCESCO, “Fjalimi për Përkujtimin e 50^e vjetorit të themelimit të Sinodit të Ipushkvijsë.”

23 FRANCESCO, “Fjalimi në fillim të Sinodit kushtuar të rinjve” (3 tetor 2018).

Indeksi

I. Apeli për të ecur së bashku	8
II. Një Kishë thelbësisht sinodale	12
III. Dëgjimi i Shkrimeve	17
Jezusi, turma, apostujt	17
Një dinamikë e dyfishtë e kthimit: Pjetri dhe Korneli (Vap 10)	20
IV. Sinodaliteti në veprim: rrugë për t'u konsultuar me Popullin e Zotit.....	22
Pyetja themelore	22
Artikulime të ndryshme të sinodalitetit	23
Dhjetë bërthama tematike për t'u thelluar	25
Për të kontribuar në konsultim.....	29

Lutja për Sinodin

Adsumus Sancte Spiritus

Gjendemi këtu përpara teje o Shpirt i Shenjtë,
jemi mbledhur të gjithë në emrin tënd.

Eja te ne,
na qëndro pranë,
zbrit në zemrat tona.
Na mëso atë çka duhet të bëjmë,
na e trego Ti udhën që duhet të ndjekim të gjithë së bashku.

Mos lejo që të dëmtohet drejtësia prej ne mëkatarëve,
mos të na e ngatërrojë rrugën padija,
mos të na bëjë të njëanshëm pëlqimi njerëzor,
që të jemi një gjë e vetme në Ty
dhe mos t'i shmangemi së vërtetës në asgjë.

Po ta kërkojmë Ty,
që vepron në çdo kohë e në çdo vend,
në bashkim me Atin dhe me Birin,
për të gjithë shekujt e shekujve.
Amen.